



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 443 Prot.

Tiranë, më 28.03 2019

**VENDIM Nr. 69 datë 18.03.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"* Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, datë 18.03.2019, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Vëzhgime përnjohëse kodrinore në zonën veri-perëndimore (Lezhë-Shkodër), 2019"* drejtuar nga Dr. Rovena Kurti, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Vëzhgime përnjohëse kodrinore në zonën veri-perëndimore (Lezhë-Shkodër), 2019"* drejtuar nga Dr. Rovena Kurti, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - Plotësimi i hartës së shtrirjes së këtyre nekropoleve, kryesisht në zonën kodrinore që kufizon në lindje fushën e Mbishkodrës, midis lumit Kir dhe kodrave të Kastratit.
  - Në zonën e Nënshkodrës, do kontrollohet përsëri gjatë sezonit të vitit 2019, me qëllim dokumentimin e ekstremit verior të kurrizit kodrinor të Rrencit, në fshatin Mal Kolaj.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2019.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR  
ELVA MARGARITI  
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO**

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)